



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINES
DREJTORIA PËR RINI DHE SPORT

F T E S Ë P Ë R A P L I K I M

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të; rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës – Drejtoria për Rini dhe Sport dhe në rregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve sportive vartëse të Komunës së Prishtinës **Drejtoria për Rini dhe Sport bënë ftesë publike për aplikim për anëtar të komisionit vlerësues për projektet nga fushat Rini dhe Sport.**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile dhe fushat e sportit, përkatësisht:

- Një përfaqësues nga OJQ-të Rinore,
- Një ekspert të fushës së sportit,

Aplikuesit duhet të jenë persona me përvojë profesionale mbi 3 vite në të paktën njërin nga fushat e lartpërmendura.

Përfaqësuesi/ja që përzgjidhet do të jetë anëtar/e i/e komisionit vlerësues me të drejtë vote për vlerësimin e projekt-propozimeve në përputhje me dispozitat ligjore.

Afati për aplikim është nga data **19.05.2025** deri më datën **29.05.2025**.

Ju lutem dërgoni brenda kësaj periudhe të aplikimit CV tuaj në postën elektronike zyrtare: sportrini.pr@rks-gov.net